REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01Nr. 1502/2026
Data: 08.10.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pika k), dhe nenit 58, pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7 të Ligjit Nr.10/L-022 për Banimin Social dhe të Përballueshëm, nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, si dhe nenit 68, paragrafi 1, dhe nenit 69, paragrafi 1, pika 4, të Statutit të Komunës së Istogut, 01Nr.62/10, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 06-553-34569, të datës 15.09.2026, të parashtruar nga z. Misin Jahaj nga Zallqi, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, si dhe duke u bazuar në gjetjet faktike dhe rekomandimin për aprovim të paraqitur në Raportin Individual të Komisionit nr.266/2026, të datës 28.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. APROVOHET, kërkesa nr. 06-553-34569, e datës 15.09.2026, e z. Misin Jahaj nga fshati Zallq, Komuna e Istogut, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, në bazë të rekomandimit të paraqitur në Raportin Individual të Komisionit nr. 266/2026, të datës 28.09.2026.

2. Për përfituesin nga pika 1 e këtij Vendimi, subvencionohet pagesa e qirasë për banim në shumën prej **200 € (dyqind euro)** në muaj, për një periudhë prej **6 (gjashtë) muajsh**, duke filluar nga data 01.10.2026 deri më datë 31.03.2027, në vlerën e përgjithshme prej **1,200 € (njëmijë e dyqind euro)**, në përputhje me propozimin e organit kompetent, dokumentacionin përkatës dhe ndarjet buxhetore të miratuara.

3. OBLIGOHET Drejtoria për Mirëqenie Sociale që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative dhe financiare për përgatitjen dhe lidhjen e kontratës me përfituesin, si dhe për realizimin e subvencionimit, në përputhje me këtë Vendim dhe dispozitat ligjore në fuqi.

4. Kontrata nga pika 3 e këtij Vendimi përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, mënyrën e realizimit të pagesave dhe dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e subvencionimit, pa ndryshuar shumën dhe periudhën e përcaktuar me këtë Vendim.

5. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe për zbatim të tij do të kujdeset Drejtoria e Mirëqenies Sociale.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë Komisionit për Ankesa të Komunës së Istogut, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***
- *Palës – z. Misin Jahaj;*
- *Drejtorisë për Mirëqenie Sociale;*
- *Komisionit për Verifikim dhe Vlerësim; dhe*
- *Arkivit të Komunës.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir PERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1500/2026 http://kk.rks-gov.net/istog/

Data: 08.10.2026

Kryetari i Komunës në mbështetjeje të Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës me ndryshim dhe plotësim përkatës si dhe nenin 39 të Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik të miratuar më datën 20.10.2022 dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim- ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, e cila ka hyrë në fuqi nga data 11.11.2024, dhe nenin 4 paragrafi 1 nenparagrafi 1.5 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025.shqyrtoj kërkesën 06 Nr.267/2026 të datës 06.10.2026 të parashtruar Drejtoria per Mirqeni Sociale per plotesim-ndryshim të Vendimit 01 Nr.942/2023 të Komisionit për shqyrtimin e kerkesave: "Lendë Djegëse Dru Zjarri per familje me nevojë dhe kushte te veshtira socio-ekonomike " nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET- Plotësim–Ndryshimi** i pikës 1. të Vendimit 01Nr.942/2023 për Komisioni për shqyrtimin e kerkesave: "Lëndë Djegëse Dru Zjarri per familje me nevojë dhe kushte te veshtira socio-ekonomike " dhe në komision caktohen.

   1.1. **Jozef Frrokaj,** Kryesues i Komisionit;
   1.2. **Getuarba Ademaj Osmanaj ,** anetare;
   1.3. **Antigona Shatri Bajraktari,** anëtare;

2. Komisioni i përcaktuar në nenin 1 të këtij Vendimi obligohet të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha kërkesave në pajtim me kriteret e përcaktuara ne dokumentacionin përkatës të aktivitetit, si dhe te kryej të gjitha detyrat dhe përgjegjësit qe janë ne kompetence te Komisionit.

3. Anëtaret e komisionit obligohen t'u përmbahen dispozitave ligjore për ruajtjen e konfidencialitetit të informatave dhe të dhënave të përfshira ne ofertat dhe dokumentacionin e operatorëve ekonomikë. Anëtaret e komisionit mbajnë përgjegjësi individuale për punën dhe vlerësimin e tyre, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik dhe akteve nënligjore përkatëse.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik dhe akteve nënligjore përkatëse.

5. Obligohen anëtaret e komisionit që brenda afatin të përcaktuar te paraqiten pranë zyrës se prokurimit për t'u ofruar qasjen në dokumentacion dhe ofertat e dorëzuara nga operatoret ekonomik.

6. Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.

7. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit,
-Prokurimit,
-Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Zyrtar Ligjor
Betim FETAHAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1499/2026
Data: 08.10.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, në pajtim me Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), ne Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-92 dhe në pajtim me Nenin 19 paragrafi 19.16 të Rregulloren Nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, shqyrtoj kërkesën 12.Nr.79/2026 të datës 08.10.2026 të parashtruar nga Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport, për emërimin e një zyrtari nga Njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/Termat e Referencës për aktivitetin e Prokurimit për projektin: "Botim i Librave", nxjerr:

V E N D I M

1. Emërohet: Naim Sadriu, Zyrtar për Standarde, Monitorim dhe Vlersim, për hartimin e specifikimeve teknike/Termat e Referencës për aktivitetin e Prokurimit për projektin: "Botim i Librave" për nevoja të Institucioneve Komunale.

2. Zyrtari i lartcekur obligohet ti hartoj Specifikimet teknike, të plotësoj dhe dorëzoj Deklaratën nen Betim duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP-ja sipas paragrafit 19.16 të Nenit 19 të Rregulloren Nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

3. Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Naim Sadriu dhe Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport.

4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Naim Sadriut,
- Drejtorisë për Kultur, Rini dhe Sport dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Zyrtar Ligjor
Betim FETAHAJ

REPUBLIKA E KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOK
REPUBLIKA KOSOVO

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01Nr. 1498/2026
Data: 08.10.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pika k), dhe nenit 58, pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7 të Ligjit Nr.10/L-022 për Banimin Social dhe të Përballueshëm, nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, si dhe nenit 68, paragrafi 1, dhe nenit 69, paragrafi 1, pika 4, të Statutit të Komunës së Istogut, 01Nr.62/10, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 06-553-34205, të datës 11.09.2026, të parashtruar nga z. Isuf Zeqiraj, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, si dhe bazuar në dokumentacionin e administruar në lëndë, gjetjet faktike dhe rekomandimin e Komisionit për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, të paraqitur në Raportin Individual për Refuzim 06Nr. 259/2026, të datës 28.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET kërkesa nr. 06-553-34205, e datës 11.09.2026, e parashtruar nga z. Isuf Zeqiraj, me adresë banimi në fshatin Shalinovicë, Komuna e Istogut, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, për shkak se nuk i plotëson kushtet materiale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, përkatësisht kushtin e përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Istogut që ta njoftojë palën me këtë Vendim dhe të ndërmarrë veprimet për përfundimin e procedurës administrative të lëndës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Istogut dhe i dorëzohet palës në pajtim me ligjin.

A R S Y E T I M I

Z. Isuf Zeqiraj ka parashtruar pranë Drejtorisë për Mirëqenie Sociale të Komunës së Istogut kërkesën nr. 06-553-34205, të datës 11.09.2026, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim.

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës, me Vendimin e Kryetarit të Komunës 01Nr.1241/2026, të datës 04.09.2026, është emëruar Komisioni për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, i cili ka shqyrtuar dokumentacionin e lëndës dhe ka kryer verifikimin përkatës.

Sipas Raportit Individual për Refuzim 06Nr.259/2026, të datës 28.09.2026, Komisioni ka konstatuar se, gjatë verifikimit, nuk janë evidentuar rrethana faktike që dëshmojnë se kërkuesi nuk kanë mundur të kontaktoj palen si dhe nuk ndodhet në gjendje nevoje apo në kushte të rënda ekonomike dhe të banimit që do të arsyetonin subvencionimin e pagesës së qirasë.

Në bazë të këtyre gjetjeve, Komisioni ka vlerësuar se kërkuesi nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, dhe ka rekomanduar refuzimin e kërkesës.

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në lëndë, gjetjeve të Komisionit dhe rekomandimit të tij, ka vlerësuar se nuk janë përmbushur kushtet materiale për përfitimin e subvencionimit të pagesës së qirasë.

Për këto arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartcekura, në gjetjet faktike dhe në rekomandimin e Komisionit, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë Komisionit për Ankesa të Komunës së Istogut, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

- ***Vendimi u dërgohet:***
- *Palës - z. Isuf Zeqiraj;*
- *Drejtorisë për Mirëqenie Sociale;*
- *Komisionit për Verifikim dhe Vlerësim; dhe*
- *Arkivit të Komunës.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01Nr. 1497/2026
Data: 08.10.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pikës k), dhe nenit 58, pikës b), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7 të Ligjit Nr.10/L-022 për Banimin Social dhe të Përballueshëm, nenit 4, paragrafit 1, nënparagrafit 1.5, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 12, paragrafit 1, nënparagrafit 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, si dhe nenit 68, paragrafit 1, dhe nenit 69, paragrafit 1, pikës 4, të Statutit të Komunës së Istogut, 01Nr.62/10, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 06-553-34899, të datës 17.09.2026, të parashtruar nga znj. Remzije Tafaj, nga Istogu, për subvencionimin/vazhdimin e subvencionimit të pagesës së qirasë për banim, si dhe bazuar në dokumentacionin e administruar në lëndë, gjetjet faktike dhe rekomandimin e Komisionit për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, të pasqyruara në Raportin Individual për Refuzim 06Nr.261/2026, të datës 28.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET kërkesa nr. 06-553-34899, e datës 17.09.2026, e parashtruar nga znj. Remzije Tafaj, nga Istogu, për subvencionimin/vazhdimin e subvencionimit të pagesës së qirasë për banim, për shkak se kërkuesja nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Istogut që ta njoftojë palën me këtë Vendim dhe të ndërmarrë veprimet për përfundimin e procedurës administrative të lëndës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Istogut dhe i dorëzohet palës në pajtim me ligjin.

A R S Y E T I M I

Znj. Remzije Tafaj ka parashtruar pranë Drejtorisë për Mirëqenie Sociale të Komunës së Istogut kërkesën nr. 06-553-34899, të datës 17.09.2026, për subvencionimin/vazhdimin e subvencionimit të pagesës së qirasë për banim.

Për shqyrtimin, verifikimin dhe vlerësimin e kërkesave për subvencionimin e pagesës së qirasë, me Vendimin e Kryetarit të Komunës 01Nr.1241/2026, të datës 04.09.2026, është emëruar Komisioni për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë.

Komisioni, më 18.09.2026, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin e administruar në lëndë, si dhe ka kryer verifikimin e drejtpërdrejtë të gjendjes faktike në terren.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimi i kryer në terren, siç është pasqyruar në Raportin Individual për Refuzim 06Nr.261/2026, të datës 28.09.2026, Komisioni ka konstatuar se kërkuesja ka deklaruar se jeton në një banesë me qira në qendër të Istogut, ndërsa fëmijët e saj nuk jetojnë me të.

Komisioni ka konstatuar gjithashtu se Komuna e Istogut e ka mbështetur më parë kërkuesen me mbulimin e pagesës së qirasë për një periudhë të gjatë, për shkak të problemeve shëndetësore që ajo kishte në atë kohë. Sipas gjetjeve të Komisionit, në kohën e verifikimit gjendja shëndetësore e kërkueses ishte stabilizuar dhe nuk janë konstatuar rrethana faktike që dëshmojnë se ajo ndodhet në gjendje nevoje apo në kushte të rënda për banim.

Në bazë të gjendjes faktike të verifikuar dhe dokumentacionit të administruar në lëndë, Komisioni ka vlerësuar se kërkuesja nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut.

Për rrjedhojë, Komisioni ka konstatuar se kërkuesja nuk i plotëson kriteret për subvencionimin/vazhdimin e subvencionimit të pagesës së qirasë dhe ka rekomanduar që kërkesa e saj të refuzohet.

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të administruar në lëndë, Raportit Individual për Refuzim 06Nr.261/2026, të datës 28.09.2026, si dhe konstatimeve dhe rekomandimit të Komisionit, vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet materiale të përcaktuara me dispozitat përkatëse për përfitimin e subvencionimit/vazhdimin e subvencionimit të pagesës së qirasë.

Për këto arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartcekura, në dokumentacionin e administruar në lëndë, në gjetjet faktike të konstatuara nga Komisioni dhe në rekomandimin e tij, të pasqyruara në Raportin Individual për Refuzim 06Nr.261/2026, të datës 28.09.2026, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë Komisionit për Ankesa të Komunës së Istogut, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***

- *Palës - znj. Remzije Tafaj;*
- *Drejtorisë për Mirëqenie Sociale;*
- *Komisionit për Verifikim dhe Vlerësim; dhe*
- *Arkivit të Komunës.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA REPUBLIKA KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01Nr. 1494/2026
Data: 07.10.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pikës k), dhe nenit 58, pikës b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7 të Ligjit Nr.10/L-022 për Banim Social dhe të Përballueshëm, nenit 4, paragrafit 1, nënparagrafit 1.5, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 12, paragrafit 1, nënparagrafit 1.8, të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, si dhe nenit 68, paragrafit 1, dhe nenit 69, paragrafit 1, pikës 4, të Statutit të Komunës së Istogut, 01Nr.62/10, **pas shqyrtimit të kërkesës** nr. 06-553-34877, të datës 17.09.2026, të parashtruar nga znj. Valentina Hakaj, me vendbanim në Dubravë, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, si dhe bazuar në dokumentacionin e administruar në lëndë, gjetjet faktike dhe rekomandimin e Komisionit për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, të pasqyruara në Raportin Individual për Refuzim me 06Nr.264/2026, të datës 28.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET kërkesa nr. 06-553-34877, e datës 17.09.2026, e parashtruar nga znj. Valentina Hakaj, me vendbanim në Dubravë, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, për shkak se nuk e plotëson kushtin material për përfitimin e subvencionimit të pagesës së qirasë, të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Istogut që ta njoftojë palën me këtë Vendim dhe të ndërmarrë veprimet për përfundimin e procedurës administrative të lëndës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Istogut dhe i dorëzohet palës në pajtim me ligjin.

A R S Y E T I M I

Znj. Valentina Hakaj ka parashtruar pranë Drejtorisë për Mirëqenie Sociale të Komunës së Istogut kërkesën nr. 06-553-34877, të datës 17.09.2026, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim.

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës, me Vendimin e Kryetarit të Komunës 01Nr. 1241/2026, të datës 04.09.2026, është emëruar Komisioni për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë.

Komisioni, më datë 18.09.2026, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin e administruar në lëndë dhe ka kryer verifikimin e drejtpërdrejtë në terren. Gjatë verifikimit, Komisioni ka konstatuar se parashtruesja aktualisht jeton te prindërit e saj së bashku me dy fëmijët dhe nuk është duke paguar qira. Gjithashtu, është konstatuar se parashtrueses i është subvencionuar pagesa e qirasë për një periudhë të caktuar, mirëpo ajo e ka ndërprerë pagesën e qirasë me vullnetin e saj.

Këto gjetje faktike janë pasqyruar në Raportin Individual për Refuzim me 06Nr.264/2026, të datës 28.09.2026, në të cilin Komisioni ka vlerësuar se parashtruesja nuk e plotëson kushtin material për përfitimin e subvencionimit të pagesës së qirasë, të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, dhe ka rekomanduar refuzimin e kërkesës.

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të administruar në lëndë, gjendjes faktike të konstatuar gjatë verifikimit në terren dhe rekomandimit të Komisionit, ka vlerësuar se nuk janë përmbushur kushtet për përfitimin e subvencionimit të pagesës së qirasë.

Për këto arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartcekura, në gjendjen faktike të konstatuar dhe në rekomandimin e Komisionit, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë Komisionit për Ankesa të Komunës së Istogut, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***
- *Palës - znj. Valentina Hakaj;*
- *Drejtorisë për Mirëqenie Sociale;*
- *Komisionit për Verifikim dhe Vlerësim; dhe*
- *Arkivit të Komunës.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.1493/2026
Data: 07.10.2026

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), nenin 59 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 18/2011), nenin 39 të Rregullës Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të miratuar më 20.10.2022 nga KRPP-ja, dhe Rregullës Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullës Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, hyrë në fuqi nga data 11.11.2024, si dhe në bazë të kërkesës/shkresës 06 Nr. 346, datë 07.10.2026, të parashtruar nga Drejtoria për Shëndetësi, për themelimin e Komisionit për pranimin e punimeve për aktivitetin "Punimi i Recepcionit në QMF e re në Gurrakoc", nr. 633-026-0321-536, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për pranimin e punimeve për aktivitetin "Punimi i Recepcionit në QMF e re në Gurrakoc", nr. 633-026-0321-536.

1.1 **Rasim Mahmutović,** Kryesues i Komisionit;

1.2 **Ardon Arifaj,** anëtar;

1.3 **Marigona Bytyqi,** anëtare;

2. Komisioni i cekur më lart ka për obligim të bëjë pranimin e punimeve për aktivitetin "Punimi i Recepcionit në QMF e re në Gurrakoc", nr. 633-026-0321-536, në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e aktivitetit përkatës dhe dokumentacionin e kontratës. Komisioni, në kuadër të përgjegjësive të tij, do të kryejë të gjitha punët dhe veprimet e nevojshme lidhur me pranimin dhe verifikimin e punimeve, në përputhje me dispozitat në fuqi.

3. Anëtarët e Komisionit janë të obliguar t'i respektojnë dispozitat e nenit 11 të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbrojtjen e informatave sekrete dhe konfidenciale, si dhe çdo dispozitë tjetër të aplikueshme.

4. Anëtarët e Komisionit kanë përgjegjësi për kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë profesionale, të paanshme dhe në pajtim me kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e prokurimit dhe kontratën përkatëse, si dhe me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizojë, këshillojë dhe drejtojë punën e Komisionit, duke siguruar respektimin e dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullave përkatëse të Prokurimit Publik.

6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe për realizimin e tij kujdesen Komisioni dhe Drejtoria për Shëndetësi.
7. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
- Komisionit;
- Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit;
- Drejtorisë për Shëndetësi; dhe
- Arkivit të Zyrës së Kryetarit.

Zyrtar Ligjor
Betim FETAHAJ

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E ISTOGUT * OPŠTINA ISTOK * REPUBLIKA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01Nr. 1492/2026
Data: 07.10.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pikës k), dhe nenit 58, pikës b), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7 të Ligjit Nr. 10/L-022 për Banim Social dhe të Përballueshëm, nenit 4, paragrafit 1, nënparagrafit 1.5, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 12, paragrafit 1, nënparagrafit 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, si dhe nenit 68, paragrafit 1, dhe nenit 69, paragrafit 1, pikës 4, të Statutit të Komunës së Istogut, 01Nr.62/10, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 06-553-33816, të datës 09.09.2026, të parashtruar nga znj. Shkurta Osmanaj, me vendbanim në Istog, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, si dhe bazuar në dokumentacionin e administruar në lëndë, gjetjet faktike dhe rekomandimin e Komisionit për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, të pasqyruara në Raportin Individual për Refuzim 06Nr.262/2026, të datës 28.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET kërkesa nr. 06-553-33816, e datës 09.09.2026, e parashtruar nga znj. Shkurta Osmanaj, me vendbanim në Istog, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, pasi nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Istogut që ta njoftojë palën me këtë Vendim dhe të ndërmarrë veprimet për përfundimin e procedurës administrative të lëndës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Istogut dhe i dorëzohet palës në pajtim me ligjin.

A R S Y E T I M I

Znj. Shkurta Osmanaj ka parashtruar pranë Drejtorisë për Mirëqenie Sociale të Komunës së Istogut kërkesën nr. 06-553-33816, të datës 09.09.2026, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim.

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës, me Vendimin e Kryetarit të Komunës 01Nr.1241/2026, të datës 04.09.2026, është emëruar Komisioni për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë.

Komisioni, më datë 18.09.2026, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin e administruar në lëndë dhe ka kryer verifikimin e drejtpërdrejtë në terren.

Nga verifikimi i drejtpërdrejtë në terren, siç është pasqyruar në Raportin Individual për Refuzim 06Nr.262/2026, të datës 28.09.2026, Komisioni ka konstatuar se parashtruesja e kërkesës ka kërkuar që Drejtoria për Mirqenie Sociale ti ndijmojë për pagesë të qerësë.

Pas daljes në terren, për verifikimin e gjendjes faktike, Komisioni ka tentuar të kontaktojë parashtruesen nëpërmjet telefonit, ndërsa, sipas të dhënave të administruara gjatë verifikimit, është kontaktuar edhe adresa e vëllait të saj, me qëllim të verifikimit të vendbanimit dhe gjendjes faktike të deklaruar. Nga ky verifikim nuk është arritur të konfirmohet se parashtruesja banon në kushtet e deklaruara në kërkesë.

Në bazë të gjendjes faktike të konstatuar gjatë verifikimit në terren dhe të dokumentacionit të administruar në lëndë, Komisioni ka vlerësuar se parashtruesja nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, i cili lidhet me plotësimin e kushteve për përfitimin e subvencionimit të pagesës së qirasë.

Për rrjedhojë, Komisioni ka rekomanduar që kërkesa e znj. Shkurta Osmanaj për subvencionimin e pagesës së qirasë të refuzohet.

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të administruar në lëndë, gjetjeve të Komisionit dhe rekomandimit të tij, ka vlerësuar se nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara për përfitimin e subvencionimit të pagesës së qirasë.

Për këto arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartcekura, në gjetjet faktike të konstatuara gjatë verifikimit në terren dhe në rekomandimin e Komisionit, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë Komisionit për Ankesa të Komunës së Istogut, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***
- *Palës - znj. Shkurta Osmanaj;*
- *Drejtorisë për Mirëqenie Sociale;*
- *Komisionit për Verifikim dhe Vlerësim; dhe*
- *Arkivit të Komunës.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01Nr. 1492/2026
Data: 07.10.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pikës k), dhe nenit 58, pikës b), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7 të Ligjit Nr. 10/L-022 për Banim Social dhe të Përballueshëm, nenit 4, paragrafit 1, nënparagrafit 1.5, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 12, paragrafit 1, nënparagrafit 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, si dhe nenit 68, paragrafit 1, dhe nenit 69, paragrafit 1, pikës 4, të Statutit të Komunës së Istogut, 01Nr.62/10, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 06-553-33816, të datës 09.09.2026, të parashtruar nga znj. Shkurta Osmanaj, me vendbanim në Istog, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, si dhe bazuar në dokumentacionin e administruar në lëndë, gjetjet faktike dhe rekomandimin e Komisionit për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, të pasqyruara në Raportin Individual për Refuzim 06Nr.262/2026, të datës 28.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **REFUZOHET** kërkesa nr. 06-553-33816, e datës 09.09.2026, e parashtruar nga znj. Shkurta Osmanaj, me vendbanim në Istog, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, pasi nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Istogut që ta njoftojë palën me këtë Vendim dhe të ndërmarrë veprimet për përfundimin e procedurës administrative të lëndës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Istogut dhe i dorëzohet palës në pajtim me ligjin.

A R S Y E T I M I

Znj. Shkurta Osmanaj ka parashtruar pranë Drejtorisë për Mirëqenie Sociale të Komunës së Istogut kërkesën nr. 06-553-33816, të datës 09.09.2026, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim.

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës, me Vendimin e Kryetarit të Komunës 01Nr.1241/2026, të datës 04.09.2026, është emëruar Komisioni për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë.

Komisioni, më datë 18.09.2026, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin e administruar në lëndë dhe ka kryer verifikimin e drejtpërdrejtë në terren.

Nga verifikimi i drejtpërdrejtë në terren, siç është pasqyruar në Raportin Individual për Refuzim 06Nr.262/2026, të datës 28.09.2026, Komisioni ka konstatuar se parashtruesja e kërkesës ka kërkuar që Drejtoria për Mirqenie Sociale ti ndijmojë për pagesë të qerësë.

Pas daljes në terren, për verifikimin e gjendjes faktike, Komisioni ka tentuar të kontaktojë parashtruesen nëpërmjet telefonit, ndërsa, sipas të dhënave të administruara gjatë verifikimit, është kontaktuar edhe adresa e vëllait të saj, me qëllim të verifikimit të vendbanimit dhe gjendjes faktike të deklaruar. Nga ky verifikim nuk është arritur të konfirmohet se parashtruesja banon në kushtet e deklaruara në kërkesë.

Në bazë të gjendjes faktike të konstatuar gjatë verifikimit në terren dhe të dokumentacionit të administruar në lëndë, Komisioni ka vlerësuar se parashtruesja nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, i cili lidhet me plotësimin e kushteve për përfitimin e subvencionimit të pagesës së qirasë.

Për rrjedhojë, Komisioni ka rekomanduar që kërkesa e znj. Shkurta Osmanaj për subvencionimin e pagesës së qirasë të refuzohet.

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të administruar në lëndë, gjetjeve të Komisionit dhe rekomandimit të tij, ka vlerësuar se nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara për përfitimin e subvencionimit të pagesës së qirasë.

Për këto arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartcekura, në gjetjet faktike të konstatuara gjatë verifikimit në terren dhe në rekomandimin e Komisionit, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë Komisionit për Ankesa të Komunës së Istogut, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***
- *Palës - znj. Shkurta Osmanaj;*
- *Drejtorisë për Mirëqenie Sociale;*
- *Komisionit për Verifikim dhe Vlerësim; dhe*
- *Arkivit të Komunës.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPSTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Istogut
Opštine Istok
Istog Municipality

01.Nr.1491/2026
Datë.07.10.2026

Baza Juridikë e Kontratës
Kryetari i Komunës bazuar në nenin 5,pika (d),të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008 mbeshtetje të nenit 6 pika 1, nënpika 1.3, të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës, lidhur me nenin 6, të Rregullores Nr.01.Nr.54/2021 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak së (1) vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës,për Dhënien në Shfrytëzim me pak së (1) vit të hapsirave publike të pronës së palujatshme të komunës së Istogut, si dhe bazuar në kërkesen me Nr.12.016-34177 të datës 11.09.2026, pas rekomandimit perfundimtar të komisionit i propozon Kryetarit të Komunës të lidhë ketë :

K O N T R A T Ë
PËR DHËNIEN E LOKALIT NË SHFRYTËZIM PËR MË PAK SË (1) NJË VITË
(Pjesë e nderteses në Shtepinë e Kultures)

E hartuar me dt.07.10.2026 në Istog, lidhur në mës të palve kontraktuese si me poshtë:

PALËT KONTRAKTUESE :

1.**Ilir FERATI, Kryetar i Komunës së Istogut i cili e përfaqëson Komunën**,për dhënien e hapësirës publike (Pjesë e nderteses) pa pagesë pronë e palujatshme e Komunës së Istogut i cila ndodhet në objektin e Shtëpisë se Kulturës „Adem Jashari"në Istog nga njera anë si dhe :

2.**Klubi Letrar „Podguri" në Istog të cilen e përfaqeson z.Nuradin Imeraj** -merr në shfrtyëzim hapësirën publike,(Pjesë e ndertesës) pronë e Komunës së Istogut e cila ndodhet në Shtepinë e Kulturës „Adem Jashari" në Istog si shfrytëzues pa pagesë në anën tjetër.

Neni 1
Objekti i Kontratës

1.Objekti i kësaj kontrate është dhënia hapësirës publike,përkatësisht (lokal për deponim)e cila do të përdoret për qellime humanitare,pronë e Komunës së Istogut e cila ndodhet në Shtepinë e Kulturës „Adem Jashari" në Istog si shfrytëzues pa pagesë në anën tjetër adresa rruga „Dëshmoret Dervishaj"nr.26 pronë e komunës së Istogut.

Neni 2
Kohëzgjatja e Kontratës

1.Palët kontraktuse janë pajtuar që afati i shfrytëzimit të hapsirës të lartëcekur të jetë nga data 08.10.2026 e deri me datë 30.09.2026. Pas kalimit të afatit të paraprë për të cilen është lidhur kjo kontrate ose ndërprejës së parakohshme të kontratës, e drejta e shfrytëzimit i kthehet pronarit, Komunës së Istogut.

2.Pas përfundimit të afatit të paraparë për të cilen është lidhur kjo kontratë,shfrytëzuesi Klubi letrar"Podguri" është i obliguar që për vazhdimin e kontrtaës të paraqesë kërkesë të re.

Neni 3
Menyra e shfrytëzimit dhe obligimet e qiramarrësit

1.Qiramarrësi obligohet që lokalin (hapësiren e dhënë) pa pagesë ta shfrytëzoj dhe mbaj në përputhje me dispozitat ligjore të kontratës, ligjeve dhe rregulloreve tjera në fuqi, përndryshe përgjëgjësinë për mirëmbajtjen gjatë gjithë kohës e mbanë shfrytëzuesi.

2.Ndersa çdo veprim tjeter që e nderrmerr shfrytëzuesi dhe i cili nuk është i paraparë në ketë kontratë obligohet ta njoftojë menjeher ta njoftoj pronarin institucionin (Komunën e Istogut).

Neni 4
Mbikqyrja e kontratës

1.E drejta e shfrytëzimit e pronës së paluajtshme të komunës më pak se një vit nuk mundet të bartet në personat e tretë,bazuar në rregulloren për percaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së palujtshme të komunës neni 13 pika 2.

2.Për mbikqyrjen dhe realizimin e kësaj kontrate do të kujdeset Drejtoria për Kultuë Rini dhe Sport e komunës së Istogut.

Neni 5
Shkëputja e kontratës

1.Kontrata mund të shkeputët në menyrë të njëanshme në rast të mospërmbushjes se obligimeve nga qiramarrësi i lokalit siç është percaktuar në ketë kontratë përkatësisht në nenin 3 të kontrataës.

Neni 6
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1.Palët zotohen se do ti përmbahen kësaj kontrate mirpo në rast të ndonjë mosmarrëveshjeve eventuale ndermjet palve kontraktuese,palët do të bejn përpjekje për të zgjidhur të gjitha mosmarrëveshjet.Në rast se nuk arrihet ndonjë marrëveshje në mes të palve ateherë kontesti do të zgjidhet në Gjykatën Themelore në Pejë Dega-Istog sipas kompetencës territoriale.

Neni 7
Kopja e kontratës

1.Kjo kontratë është përpiluar në kopje të mjaftueshme saktësisht në 4 (katër) kopje të njëjta prej të cilave nga një(1) kopje për shfrytëzuesin, një (1) një kopje për zyren e kryetarit një (1) mbetët në dosje dhe një për Drejtorine për Kulturë Rini dhe Sport.

Neni 8
Pjesë perberse të kontrates

1.Pjesë perberses të kesaj kontrate janë : Kerkesa zytrtare për vazhdim,kontrata paraprake, Rekomandimi perfundimtar i komisionit.

Neni 9
Hyrja në fuqi

1.Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët kontraktuese

PALËT KONTRAKTUESE

z.Ilir FERATI

Kryetar i Komunës së Istogut

Klubi Letrar „Podguri"

z.Nuradin Imeraj

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1490/2026
Data: 07.10.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, në pajtim me Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), ne Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-92 dhe në pajtim me Nenin 19 paragrafi 19.16 të Rregulloren Nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, shqyrtoj kërkesën 05. Nr. 578/2026 të datës 06.10.2026 të parashtruar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, për emërimin e një zyrtari nga Njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/Termat e Referencës për aktivitetin e Prokurimit për projektin: "Renovimi i toaleteve në shkollen fillore"Hysni Zajmi"-Vrellë dhe "Trepça"-Banjë", nxjerr:

V E N D I M

1. Emërohet: Naser Gjoci, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, për hartimin e specifikimeve teknike/Termat e Referencës për aktivitetin e Prokurimit për projektin: " Renovimi i toaleteve në shkollen fillore"Hysni Zajmi"-Vrellë dhe "Trepça"-Banjë" për Drejtoria Komunale e Arsimit.

2. Zyrtari i lartcekur obligohet ti hartoj Specifikimet teknike, të plotësoj dhe dorëzoj Deklaratën nen Betim duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP-ja sipas paragrafit 19.16 të Nenit 19 të Rregulloren Nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Naser Gjoci dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Naser Gjoci,
- Drejtoria Komunale e Arsimit dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Zyrtar Ligjor
Betim FETAHAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.1489/2026
Data: 07.10.2026

Kryetari i Komunës, në pajtim me Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), ne Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-92 dhe në pajtim me Nenin 19 paragrafi 19.16 të Rregulloren Nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, shqyrtoj kërkesën Nr 11-351-204 të datës 07.10.2026 të parashtruar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, për emërimin e një zyrtari nga Njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/Termat e Referencës për aktivitetin e Prokurimit për projektin: ."Shërbime Konsulente per Zyrtar te Adresave", nxjerr:

V E N D I M

1. Emërohet: Aurela Sadikaj, Zyrtare e lart per Arkitektur, për hartimin e specifikimeve teknike/Termat e Referencës për aktivitetin e Prokurimit për projektin:"Shërbime Konsulente për Zyrtar te Adresave" Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mjedis.

2. Zyrtari i lartcekur obligohet ti hartoj Specifikimet teknike, të plotësoj dhe dorëzoj Deklaratën nen Betim duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP-ja sipas paragrafit 19.16 të Nenit 19 të Rregulloren Nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Aurela Sadikaj dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis.

4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Aurela Aadikaj,
- Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Zyrtar Ligjor
Betim FETAHAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS ② KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01Nr. 1488/2026
Data: 07.10.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pikës k), dhe nenit 58, pikës b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7 të Ligjit Nr.10/L-022 për Banimin Social dhe të Përballueshëm, nenit 4, paragrafit 1, nënparagrafit 1.5, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 12, paragrafit 1, nënparagrafit 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, si dhe nenit 68, paragrafit 1, dhe nenit 69, paragrafit 1, pikës 4, të Statutit të Komunës së Istogut, 01Nr.62/10, **pas shqyrtimit të kërkesës** nr. 06-553-33242, të datës 04.09.2026, të parashtruar nga znj. Zelfija Ahmetoviq, nga Gjurakoci, për subvencionimin/vazhdimin e subvencionimit të pagesës së qirasë për banim, si dhe bazuar në dokumentacionin e administruar në lëndë, gjetjet faktike dhe rekomandimin e Komisionit për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, të pasqyruara në Raportin Individual për Refuzim 06Nr.257/2026, të datës 28.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET kërkesa nr. 06-553-33242, e datës 04.09.2026, e parashtruar nga znj. Zelfija Ahmetoviq, nga Gjurakoci, për subvencionimin/vazhdimin e subvencionimit të pagesës së qirasë për banim, pasi nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Istogut që ta njoftojë palën me këtë Vendim dhe të ndërmarrë veprimet për përfundimin e procedurës administrative të lëndës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Istogut dhe i dorëzohet palës në pajtim me ligjin.

A R S Y E T I M I

Znj. Zelfija Ahmetoviq ka parashtruar pranë Drejtorisë për Mirëqenie Sociale të Komunës së Istogut kërkesën nr. 06-553-33242, të datës 04.09.2026, për subvencionimin/vazhdimin e subvencionimit të pagesës së qirasë për banim.

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës, me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 01Nr. 1241/2026, të datës 04.09.2026, është emëruar Komisioni për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë.

Komisioni, më datë 28.09.2026, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin e administruar në lëndë, si dhe ka kryer verifikimin e drejtpërdrejtë në terren.

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i kryer, siç është pasqyruar në Raportin Individual për Refuzim nr. 06Nr.257/2026, të datës 28.09.2026, Komisioni ka konstatuar se kërkuesja jeton me bashkëshortin dhe katër fëmijët në banesë me qira në qendër të Istogut. Po ashtu, Komisioni ka konstatuar se bashkëshorti dhe djali i saj i rritur janë të aftë për punë.

Në bazë të verifikimit të kryer, Komisioni ka vlerësuar se nuk janë konstatuar rrethana faktike që dëshmojnë se familja ndodhet në gjendje nevoje apo në kushte të rënda ekonomike, ndërsa është konstatuar se familja ka kapacitet të mjaftueshëm ekonomik për përballimin e shpenzimeve të banimit.

Për rrjedhojë, Komisioni ka konstatuar se kërkuesja nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, dhe ka rekomanduar që kërkesa për subvencionimin/vazhdimin e subvencionimit të pagesës së qirasë të refuzohet.

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të administruar në lëndë, gjetjeve të Komisionit dhe rekomandimit të tij, ka vlerësuar se nuk janë përmbushur kushtet materiale për përfitimin e subvencionimit të pagesës së qirasë.

Për këto arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartcekura, në gjetjet faktike të konstatuara nga Komisioni dhe në rekomandimin e tij, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë Komisionit për Ankesa të Komunës së Istogut, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

- ***Vendimi u dërgohet:***
- *Palës - znj. Zelfija Ahmetoviq;*
- *Drejtorisë për Mirëqenie Sociale;*
- *Komisionit për Verifikim dhe Vlerësim; dhe*
- *Arkivit të Komunës.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01Nr. 1487/2026
Data: 07.10.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pika k), dhe nenit 58, pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7 të Ligjit Nr. 10/L-022 për Banimin Social dhe të Përballueshëm, nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, si dhe nenit 68, paragrafi 1, dhe nenit 69, paragrafi 1, pika 4, të Statutit të Komunës së Istogut, 01Nr.62/10, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 06-553-33393, të datës 07.09.2026, të parashtruar nga znj. Sadete Bajramaj, nga fshati Cerrcë, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, si dhe bazuar në dokumentacionin e administruar në lëndë, gjetjet faktike dhe rekomandimin e Komisionit për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, të pasqyruara në Raportin Individual për Refuzim 06Nr.263/2026, të datës 28.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **REFUZOHET** kërkesa nr. 06-553-33393, e datës 07.09.2026, e parashtruar nga znj. Sadete Bajramaj, nga fshati Cerrcë, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, pasi nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Istogut që ta njoftojë palën me këtë Vendim dhe të ndërmarrë veprimet për përfundimin e procedurës administrative të lëndës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Istogut dhe i dorëzohet palës në pajtim me ligjin.

A R S Y E T I M I

Znj. Sadete Bajramaj ka parashtruar pranë Drejtorisë për Mirëqenie Sociale të Komunës së Istogut kërkesën nr. 06-553-33393, të datës 07.09.2026, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim.

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës, me Vendimin e Kryetarit të Komunës 01Nr.1241/2026, të datës 04.09.2026, është emëruar Komisioni për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, i cili ka shqyrtuar dokumentacionin e administruar në lëndë dhe ka kryer verifikimin e drejtpërdrejtë në terren.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimi i kryer në terren, të pasqyruara në Raportin Individual për Refuzim 06Nr.263/2026, të datës 28.09.2026, Komisioni ka konstatuar se kërkuesja jeton me bashkëshortin dhe katër fëmijët në një banesë me qira në qendër të Istogut. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se bashkëshorti dhe djali i saj i rritur janë të aftë për punë.

Bazuar në këto gjetje dhe në shqyrtimin e dokumentacionit të administruar, Komisioni ka vlerësuar se kërkuesja nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut dhe ka rekomanduar refuzimin e kërkesës për subvencionimin e pagesës së qirasë.

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të administruar në lëndë, gjetjeve të verifikimit në terren dhe rekomandimit të Komisionit, ka vlerësuar se nuk janë përmbushur kushtet materiale për përfitimin e subvencionimit të pagesës së qirasë.

Për këto arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartcekura, në gjetjet faktike të konstatuara nga Komisioni dhe në rekomandimin e tij, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë Komisionit për Ankesa të Komunës së Istogut, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***
- *Palës - znj. Sadete Bajramaj;*
- *Drejtorisë për Mirëqenie Sociale;*
- *Komisionit për Verifikim dhe Vlerësim; dhe*
- *Arkivit të Komunës.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01Nr. 1486/2026
Data: 07.10.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pika k), dhe nenit 58, pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7 të Ligjit Nr.10/L-022 për Banimin Social dhe të Përballueshëm, nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, si dhe nenit 68, paragrafi 1, dhe nenit 69, paragrafi 1, pika 4, të Statutit të Komunës së Istogut, 01Nr.62/10, **pas shqyrtimit të kërkesës** nr. 06-553-31931, të datës 26.08.2026, të parashtruar nga z. Liridon Rugovaj, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, si dhe bazuar në dokumentacionin e administruar në lëndë, gjetjet faktike dhe rekomandimin e Komisionit për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, të pasqyruara në Raportin Individual për Refuzim, 06 Nr.258/2026, të datës 28.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET kërkesa nr. 06-553-31931, e datës 26.08.2026, e parashtruar nga z. Liridon Rugovaj, me adresë të banimit në fshatin Vrellë, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, për shkak se nuk i plotëson kushtet materiale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe, në veçanti, kushtin e përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Istogut që ta njoftojë palën me këtë Vendim dhe të ndërmarrë veprimet për përfundimin e procedurës administrative të lëndës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Istogut dhe i dorëzohet palës në pajtim me ligjin.

A R S Y E T I M I

Z. Liridon Rugovaj ka parashtruar pranë Drejtorisë për Mirëqenie Sociale të Komunës së Istogut kërkesën nr. 06-553-31931, të datës 26.08.2026, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim.

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës, me Vendimin e Kryetarit të Komunës 01Nr. 1241/2026, të datës 04.09.2026, është emëruar Komisioni për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, i cili ka shqyrtuar dokumentacionin e lëndës dhe ka kryer verifikimin e drejtpërdrejtë në terren.

Nga verifikimi i kryer në terren, siç është konstatuar në Raportin Individual për Refuzim 06Nr.258/2026, të datës 28.09.2026, Komisioni ka konstatuar se kërkuesi me familjen e tij disponon dhe shfrytëzon hapësirë banimi në pronën e tij, ndërsa nuk janë evidentuar rrethana faktike që dëshmojnë mungesën e një zgjidhjeje të banimit apo kushte të tilla të rënda banimi që do të arsyetonin subvencionimin e pagesës së qirasë.

Bazuar në këto gjetje, Komisioni ka vlerësuar se kërkuesi nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, dhe ka rekomanduar refuzimin e kërkesës për subvencionimin e pagesës së qirasë.

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të administruar në lëndë, gjetjeve të verifikimit në terren dhe rekomandimit të Komisionit, ka vlerësuar se nuk janë përmbushur kushtet ligjore dhe materiale për përfitim nga subvencionimi i pagesës së qirasë.

Për këto arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartcekura, në gjetjet faktike të konstatuara nga Komisioni dhe në rekomandimin e tij, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë Komisionit për Ankesa të Komunës së Istogut, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***

- *Palës - z. Liridon Rugovaj;*
- *Drejtorisë për Mirëqenie Sociale;*
- *Komisionit për Verifikim dhe Vlerësim; dhe*
- *Arkivit të Komunës.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.1485/2026
Datë:07.10.2026

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 9, paragrafi 2 të ligjit Nr. 08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e nenin 35, paragrafi 3 të Ligjit NR. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 2/2025), nenin 68 të Statutit Nr. 01/62-2010 të Komunës së Istogut, të miratuar më datë 30.11.2010, nxjerrë:

V E N D I M

1. z, Afrim Metaj, i punësuar sipas akt emërimit: Zyrtar i Lartë Ligjor në Sektorin Ligjor, i caktuar me vendimin 01Nr.341/2026 Ushtrues i Detyrës Udhëheqës i Sektorit Ligjor në Komunën e Istogut, i vazhdohet ushtrimi i detyrës për gjashtë (6) muaj.

2. Ushtrimi i detyrës Udhëheqës i Sektorit Ligjor i vazhdohet për gjashtë (6) muaj, duke filluar nga data 08.10.2026, deri me 07.04.2027. Gjatë kësaj periudhe pezullohen ushtrimi i detyrave dhe përgjegjësive në pozitën e rregullt sipas Akt emërimit.

3. Pas përfundimit të afatit të cekur në pikën II të këtij Vendimi, z. Afrim Metaj, kthehet në pozitën e mëparshme, në përputhje me Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

4. Obligohet Zyrtarja Financiare - Përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime që këtë Vendim ta përcjellë në Ministrinë e Financave, Punëve dhe Transfereve - Divizionin e Pagave, me qëllim që z.Afrim Metaj të figurojë në listën e pagave si Ushtrues i Detyrës në pozitën e punës: Udhëheqës i Sektorit Ligjor për gjashtë (6) muaj.

5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës. Për zbatimin e tij do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyrtarja Financiare - Përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime, dhe z. Afrim Metaj.

6. Ky Vendim është përfundimtar.

KËSHILLË JURIDIKE

Ky Vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk lejohet ankesë. Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt Administrativ ne gjykatën Administrative në Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- z. Afrim Metaj,
- Zyra e Burimeve Njerëzore,
- Zyrtares Financiare - Përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime,
- Arkivit të Zyrës së Kryetarit.

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01Nr. 1482/2026
Data: 06.10.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pika k), dhe nenit 58, pika b), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7 të Ligjit Nr. 10/L-022 për Banimin Social dhe të Përballueshëm, nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut, si dhe nenit 68, paragrafi 1, dhe nenit 69, paragrafi 1, pika 4, të Statutit të Komunës së Istogut, 01Nr.62/10, **pas shqyrtimit të kërkesës** nr. 06-553-31911, të datës 26.08.2026, të parashtruar nga znj. Shkendije Igrishta, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, si dhe bazuar në dokumentacionin e administruar në lëndë, në gjetjet dhe rekomandimin e Komisionit për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, të pasqyruara në Raportin Individual për Refuzim, 06 Nr.260/2026, të datës 28.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **REFUZOHET** kërkesa nr. 06-553-31911, e datës 26.08.2026, e parashtruar nga znj. Shkendije Igrishta, me adresë të deklaruar të banimit në fshatin Bellopojë, Komuna e Istogut, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, bazuar në gjetjet faktike dhe rekomandimin e Komisionit për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, të pasqyruara në Raportin Individual për Refuzim, 06Nr.260/2026, të datës 28.09.2026.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Istogut që ta njoftojë palën me këtë Vendim dhe të përfundojë procedurën administrative të lëndës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Istogut dhe i dorëzohet palës në pajtim me ligjin.

A R S Y E T I M I

Znj. Shkendije Igrishta ka parashtruar pranë Drejtorisë për Mirëqenie Sociale të Komunës së Istogut kërkesën nr. 06-553-31911, të datës 26.08.2026, për subvencionimin e pagesës së qirasë për banim, duke deklaruar si adresë të banimit fshatin Bellopojë, Komuna e Istogut.

Në kuadër të shqyrtimit të kërkesës, Komisioni për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Subvencionimin e Pagesës së Qirasë, i emëruar me Vendimin e Kryetarit të Komunës 01Nr.1241/2026, të datës 04.09.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e lëndës dhe ka kryer verifikimin e drejtpërdrejtë në terren. Sipas Raportit Individual për Refuzim, 06Nr.260/2026, të datës 28.09.2026, Komisioni ka konstatuar se pala, pavarësisht adresës së deklaruar në fshatin Bellopojë, aktualisht jeton me dy fëmijët e saj në territorin e Komunës së Pejës.

Po ashtu, gjatë verifikimit në terren, pala nuk është gjetur në adresën e deklaruar dhe nuk ka qenë e mundur të kontaktohet në numrin e telefonit të paraqitur në lëndë, për çka nuk është bërë i mundur verifikimi i plotë i gjendjes së saj socio-ekonomike.

Bazuar në gjetjet e verifikimit, Komisioni ka vlerësuar se pala nuk e plotëson kushtin material të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut dhe ka rekomanduar refuzimin e kërkesës për subvencionimin e pagesës së qirasë.

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të administruar në lëndë, Raportit të Komisionit dhe rekomandimit të tij, ka vlerësuar se nuk janë vërtetuar kushtet e nevojshme për përfitim nga subvencionimi i pagesës së qirasë, në pajtim me dispozitat e nenit 7 të Ligjit Nr. 10/L-022 për Banimin Social dhe të Përballueshëm dhe nenit 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Istogut.

Për këto arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartcekura, si dhe në gjetjet faktike dhe rekomandimin e Komisionit, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë parashtroj ankesë ndaj Komisionit për Ankesa të Komunës së Istogut, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

- ***Vendimi u dërgohet:***
- *Palës (Znj. Shkendije Igrishta);*
- *Drejtorisë për Mirëqenie Sociale;*
- *Komisionit për Verifikim dhe Vlerësim; dhe*
- *Arkivit të Komunës.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.1479/2026
Data: 06.10.2026

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 pika 2 dhe 3 e Ligjin Nr.03/L-212 të Punës, nenit 65 dhe 86 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtaret Publik, nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistenteve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, merr ketë vendim për transferim të mësimdhënëses Arbenita Selmani-Çapkunaj nga SHFMU "Martin Camaj" Gurrakoc në listë të pagave në SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë dhe nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Znj. Arbenita Selmani-Çapkunaj mësimdhënëse e Edukatës Qytetare në SHFMU "Martin Camaj" në Gurrakoc, kalon në listë të pagave në SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë me plotësim norme në SHFMU "Mehmet Akifi" Shushicë.
II. Koeficienti nuk ndryshon E19 -6.6
III. Ndryshon, institucioni ku mësimdhënësi kalon me listë të pagave.
IV. E punësuara obligohet që më punë në SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë të filloj nga data 01.10.2026.

Arsyetimi:

Kryetari i Komunës merr vendim që mësimdhënësja Arbenita Selmani-Çapkunaj të transferohet në SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë me plotësim norme në SHFMU "Mehmet Akif" në Shushicë.

Andaj kalimi nga SHFMU "Martin Camaj" Gurrakoc në listë të pagave në SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë behet për shkak të plotësimit të normës së orëve me rastin e pensionimit të mësimdhënësit Enver Maxharraj.

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që këtë ndryshim ta përcjellë tek Divizioni i Pagesave në Ministrinë e Financave.

Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:
- Arbenita Selmani-Çapkunaj,
-Drejtoria Komunale të Arsimit
-Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
-Drejtorisë së SHFMU-së "Hysni Zajmi" në Vrellë
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Zyrtari i Lartë Ligjorë
Sami Metaj

Kryetari i Komunës
z.Ilir Ferati

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01 Nr. 1478/2026
Datë: 06.10.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008)*, nenit 69, paragrafi 1, pikave 3 dhe 4 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/10, si dhe në pajtim me nenin 19, paragrafin 19.16 të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, **pas shqyrtimit të kërkesës** me 12Nr.77/2026 të datës 05.10.2026, të paraqitur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet z. Drin Sadikaj, U.d. i Udhëheqësit të Sektorit në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Istogut, si zyrtar përgjegjës nga Njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike për aktivitetin e prokurimit me titull: „Për ekspert të jashtëm - Arkeolog".

2. Personi i emëruar sipas pikës 1 të këtij vendimi obligohet që, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, të hartojë specifikimet teknike për aktivitetin e prokurimit të lartpërmendur. Së bashku me specifikimet teknike, zyrtari obligohet të plotësojë dhe të dorëzojë Deklaratën nën Betim, sipas formularit standard të miratuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), në pajtim me nenin 19, paragrafin 19.16 të Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik.

3. 3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet z. Drin Sadikaj, ndërsa Zyra e Prokurimit obligohet për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme procedurale në kuadër të përgjegjësive të saj ligjore.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe është përfundimtar.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***
- *z. Drin Sadikaj;*
- *Zyrës së Prokurimit;*
- *Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport; dhe*
- *Arkivit të zyrës së Kryetarit.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr. 1477/2026
Data: 05.10.2026

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58, pikës b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), si dhe nenit 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), dhe në përputhje me Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave Nr. 03/2021 të Kuvendit Komunal të Istogut të aprovuar me datë 06.07.2021, Drejtoria për Shërbimeve Publike ka shqyrtuar kërkesën 08Nr.120-35998 të datës 28.09.2026, të parashtruar nga Igballe Nekaj nga Istogu, për ofrimin e ndihmës financiare për shpenzimet e varrimit për bashkëshortin Arben Nekaj dhe me shkresën 08Nr.342/2026. të datës 05.10.2026 të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: Kërkesa 08Nr.120-35998 të datës 28.09.2026 e parashtruar nga Igballe Nekaj për mbështetje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e bashkëshortit Arben Nekaj me shumën prej dyqind euro (200,00)€ nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga fondi burimor 21 - përfitues individual me P.I. kod ekonomik 22202, për shpenzimet e varrimit nga programit buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.

2. Mjetet e miratuara në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në llogarinë bankare te Igballe Nekaj në përputhje me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike.

4. Ky Vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Palës së pakënaqur i lejohet të hapë një konflikt administrativ pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Igballe Nekaj,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivit të zyrës së Kryetarit.

UD.Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim METAJ

Kryetari i Komunës
z.Ilir ÇERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 1476/2026
Data: 05.10.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58, pikës b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), si dhe nenit 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), dhe në përputhje me Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave Nr.03/2021 të Kuvendit Komunal të Istogut të aprovuar me datë 06.07.2021,Drejtoria për Shërbimeve Publike ka shqyrtuar kërkesën 08Nr.120-36140 të datës 30.09.2026,të parashtruar nga Sadat Rugova nga Cerrca, Komuna e Istogut, për ofrimin e ndihmës financiare për shpenzimet e varrimit me rastin e vdekjes së nënës Rrushe Rugova dhe me shkresën 08Nr.343/2026të datës 05.10.2026 të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET:Kërkesa 08Nr.120-36140 të datës 30.09.2026 e parashtruar nga Sadat Rugova për mbështetje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Rrushe Rugova me shumën prej dyqind euro (200,00)€ nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga fondi burimor 21-përfitues individual me P.I. kod ekonomik 22202, për shpenzimet e varrimit nga programit buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.

2. Mjetet e miratuara në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në llogarinë bankare te Sadat Rugova në përputhje me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike.

4. Ky Vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Palës së pakënaqur i lejohet të hapë një konflikt administrativ pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Sadat Rugova,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivit të zyrës së Kryetarit.

UD.Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim METAJ

Kryetari i Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1475/2026
Data: 05.10.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, në pajtim me Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), ne Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-92 dhe në pajtim me Nenin 19 paragrafi 19.16 të Rregulloren Nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, shqyrtoj kërkesën: 03/Nr.17/2026 të datës 02.10.2026 të parashtruar nga Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, për caktimin e zyrtarit për përcaktimin e specifikave teknike për aktivitetin "Dislokimi dhe Intervenimi në Rrjetin Elektrik në Komunen e Istogut" për nevoja të Institucionit Shëndetsor Komunal, nxjerr:

V E N D I M

1. Emërohet: Rasim Mahmutović, Udhëheqës i sektorit për Komunitete dhe Kthimë Istog për hartimin e specifikave teknike për aktivitetin "Dislokimi dhe Intervenimi në Rrjetin Elektrik në Komunen e Istogut" për nevoja të Institucionit Komunal.

2. Obligohet ti hartoj Specifikimet teknike, të plotësoj dhe dorëzoj Deklaratën nen Betim duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP-ja sipas paragrafit 19.16 të Nenit 19 të Rregulloren Nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim Rasim Mahmutović.

4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
- Rasim Mahmutović,
- Prokurimit
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Zyrtar Ligjor
Betim FETAHAJ

Kryetari i Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1474/2026 http://kk.rks-gov.net/istog/
Data: 02.10.2026

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar ne nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10,bazuar në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.8, të Rregullores 01.Nr.146/2025 Për Ndarjen e Subvencioneve, Drejtoria për Administratë,shqyrtoj kërkesën 02-Nr.400-35985 të datës 28.09.2026 të parashtruar nga Shoqata Komunale e të Verbërve në Istog,për mbështetje financiare me rastin e shënimit të javës"Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë" dhe me kërkesë 02Nr.57/2026 të datës 29.09.2026, nxjerr:

V E N D I M

1.MIRATOHET: kërkesa 02-Nr.400-35985 e datës 28.09.2026 e parashtruar nga Shoqata e Komunale e të Verbërve, për përkrahje të organizimit e aktiviteteve ne kuadër te shënimit të Ditës së Njeriut me Shkop të Bardhë. dhe përkrahet me **pesëqind euro (500,00),** nga nënprogrami buxhetor i Barazis Gjinore ,kategoria ekonomike Subvencione dhe Transafere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Administrat Komunale.

2. Mjetet e miratuara në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë te OJQ Shoqata Komunale e të Verbërve ne Istog me përfaqësues Esat Shabanaj OJQ ,SHKV Istog, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Administrat Komunale .

4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- OJQ , Shoqatës Komunale të Verbërve,
-Drejtorisë për Administrat Komunale,
-Arkivi i zyrës së Kryetarit

U.D. Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim Metaj

Kryetari i Komunës
z. Ilir PERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1472 /2026
Data: 02.10.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Duke vendosur sipas njoftimit Nr.938/26 të datës 30.09.2026 të ndërmjetësuar nga drejtori i SHFMU-së "Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe" në Uçë për konfirmimin e pushimit të lehonisë për mësimdhënësen e mësimit klasor (1-5) znj.Donjeta Curraj lidhur me këtë Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 49. pika 1. e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 13 Rregullores (QRK) NR. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik merr këtë:

V E N D I M

I. znj.Donjeta Curraj e sistemuar në vendin e punës, mësimdhënëse e mësimit klasor (1-5) në SHFMU "Tre Deshmoret e Shkollës Shqipe" në Uçë i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajve, pushimi fillon me 01.10.2026 e deri me 30.09.2027.

II. Sipas pikës 3 të nenit 49, gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë paguhen nga punëdhënësi 70% nga paga bazë duke filluar nga 01.10.2026 e deri me 31.03.2027.

III. Sipas pikës 4 të nenit 49 , tre muajt vijues të pushimit të lehonisë paguhen nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në nivel të Kosovës duke filluar nga data 01.04.2027 e deri me 30.06.2027.

IV. Sipas pikës 5 të nenit 49, lehona ka të drejtë të zgjasë pushimin e lehonisë edhe për tre muaj por pa pagesë.

V. Sipas pikës 6 të nenit 49, nëse lehona nuk dëshiron të shfrytëzoj të drejtën sipas pikës 4 dhe 5 është e obliguar që 15 ditë para skadimit të pushimit sipas nenit 3 të lajmëroj punëdhënësin për fillim të punës.

Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria Komunale e Arsimit, Shkolla "Tre Deshmoret e Shkollës Shqipe" Uçë dhe Mësimdhënësja.

Vendimi i dërgohet:

-Mësimdhënëses Donjeta Curraj;
-Drejtorisë Komunale të Arsimit;
-Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
-SHFMU "TDSH" Uçë.

Zyrtari i Lartë Ligjorë
Sami Metaj

Kryetari i Komunës
z.Ilir Ferati

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 1467/2026
Data: 02.10.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në Nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në nenin 70 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe ne fuqi nga data 01.11.2022 dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 30.09.2026 të parashtruar nga Prokurimi, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës për projektin:"Shitja e Automjeteve Jashtë Përdorimit " me numër të prokurimi 633-26-7412-1-6-10 dhe nxjerr:

V E N D I M

1.CAKTOHET: Menaxher i kontratës, Idriz Imeraj për projektin "Shitja e Automjeteve Jashtë Përdorimit"dhe me numër të prokurimi 633-26-7412-1-6-10, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës **CAKTOHET: Driton Alihajdaraj** Drejtor për Administratë, për kontratën lidhur në mes të Menaxherit të Prokurimit dhe fituesve të tenderit.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022.

3. Përgjegjësin për realizimin e projekteve të lartcekura e marrin: Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
- Prokurimit,
-Idriz Imeraj,
- Drejtorisë për Administratë,
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

U.D. Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim Metaj

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 1465/2026 http://kk.rks-gov.net/istog/
Data: 02.10.2026

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 39 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 30.09.2026 të parashtruar nga Prokurimi për themelimin e Komisionit vlerësues të aktivitetit për projektin: "Shitja e Automjeteve Jashtë Përdorimit " për nevoja të institucioneve Komunale nxjerr:

V E N D I M

1. **THEMELOHET:** Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: "Shitja e Automjeteve Jashtë Përdorimit ", me numër të prokurimi 633-26-7412-1-6-10 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-026-046 dhe në komision caktohen.

1.1.Kushtrim Gecaj, Kryesues i Komisionit;
1.2 Kaltrina Kukleci, anëtar;
1.3. Berat Gjoci, anëtar;

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e aktivitetit për projektin, "Shitja e Automjeteve Jashtë Përdorimit "sipas pikës një të këtij vendimi, me qellim të konstatimit të aktivitetit vlerësues si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtaret e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtaret e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 39 të Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtaret e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit t`iu ofroj qasje në oferta qe kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Administratë.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit,
-Prokurimit,
- Drejtorisë për Administratë dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

U.D. Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim Metaj

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republic of Kosova - Republika Kosova
Komuna e Istog
Municipality of Istog - Opština Istok

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01 Nr. 1464/ 2026
Datë: 02.10.2026

Kryetari i Komunës së Istogut, në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neneve 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), nenit 68, paragrafi 1, pika 2 të Statutit të Komunës së Istogut Nr. 01-62/10, të miratuar më 30.11.2010, si dhe nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 146/2025, të miratuar më 31.07.2025, duke u bazuar në shqyrtimin dhe vlerësimin e bërë nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për përkrahje me lëndë djegëse (karburant) për nevoja shëndetësore, lidhur me kërkesën me nr. 06-553-35787, të datës 25.09.2026, të paraqitur nga Safet Kerellaj, nga fshati Drejë, Komuna e Istogut, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant) për realizimin e transportit për trajtim me radioterapi në Shërbimin Onkologjik pranë QSKUK-së në Prishtinë, si dhe duke u bazuar në dokumentacionin mjekësor të paraqitur dhe në procesverbalin e Komisionit nr. 344/2026, të datës 30.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa me nr. 06-553-35787, të datës 25.09.2026, e paraqitur nga Safet Kerellaj, nga fshati Drejë, Komuna e Istogut, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant) për realizimin e transportit për trajtim me kimioterapi në Shërbimin Onkologjik pranë QSKUK-së në Prishtinë, në relacionin Istog - Prishtinë dhe anasjelltas. Bazuar në dokumentacionin mjekësor të paraqitur dhe në procesverbalin e Komisionit nr. 344/2026, të datës 30.09.2026, sipas të cilit përfituesi do t'i nënshtrohet **30 (tridhjetë) fraksioneve** të radioterapi, përcaktohet sasia prej **450 (katërqind e pesëdhjetë) litra lëndë djegëse (karburant),** përkatësisht nga **15 (pesëmbëdhjetë) litra për secilën seancë**, në pajtim me nenin 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 146/2025.

2. Obligohet Zyrtari i Transportit që ta pajisë z. Nasret Dinaj me vërtetim për furnizim me karburant për automjetin e tij, i cili do të shfrytëzohet për realizimin e transportit të z. Safet Kerellaj për trajtim shëndetësor në Shërbimin Onkologjik pranë QKUK-së në Prishtinë, në sasinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
Furnizimi me karburant do të realizohet në përputhje me procedurat në fuqi dhe në kuadër të programit buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
Për zbatimin e këtij vendimi përgjegjëse janë Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.

4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE
Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në procedurë administrative. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ duke paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

➢ *Vendimi u dërgohet:*
- *Safet Kerellaj;*
- *Drejtorisë për Shëndetësi;*
- *Zyrtarit të Transportit; dhe*
- *Arkivi i Zyrës së Kryetarit.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republic of Kosova - Republika Kosova
Komuna e Istog
Municipality of Istog - Opština Istok

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01 Nr. 1463/2026
Datë: 02.10.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, pika b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neneve 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), neni 68, pika 1 dhe 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010, dhe neni 11 paragrafi 1, nenparagrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025, **pas shqyrtimit të kërkesës** me nr. 06-553-35686, të datës 24.09.2026, të parashtruar nga Ardita Veselaj nga fshati Dragolec, Komuna e Istogut, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant) për nevoja shëndetësore, përkatësisht për realizimin e transportit për trajtim në Shërbimin Onkologjik pranë QSKUK-së në Prishtinë, duke u bazuar në dokumentacionin mjekësor të paraqitur dhe në procesverbalin e Komisionit nr. 343/2026, të datës 29.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa me nr. 06-553-35686, e datës 24.09.2026, e parashtruar nga Ardita Veselaj, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për realizimin e transportit të saj për trajtim me kimioterapi me (6 fraksione) në Shërbimin Onkologjik pranë QSKUK-së në Prishtinë, në relacionin Istog - Prishtinë dhe anasjelltas (15 litra karburant për një seancë).
Sasia prej 90 (nëntëdhjetë) litra lëndë djegëse (karburant) përcaktohet në bazë të procesverbalit të Komisionit nr. 343/2026, të datës 29.09.2026, të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit.

2. Obligohet Zyrtari i Transportit që të pajisë parashtruesen e kërkesës me vërtetim për furnizim me karburant për automjetin në pronësi apo përdorim të saj, i cili do të shfrytëzohet për realizimin e transportit për qëllime trajtimi shëndetësor, në sasinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
Furnizimi me karburant realizohet në përputhje me procedurat në fuqi, në kuadër të programit buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
Për zbatimin e këtij vendimi përgjegjëse janë Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.

4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE
Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në procedurë administrative. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ duke paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***
- *Ardita Veselaj;*
- *Drejtorisë për Shëndetësi;*
- *Zyrtarit të Transportit; dhe*
- *Arkivi i Zyrës së Kryetarit.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.1462/2026
Data:01.10.2026

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 11,13, dhe 58 pika h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01Nr.62.2010 i miratuar me datën 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Grupi punues për Plotësim -Ndryshimin e Rregullores 001Nr.146/2025 Për Ndarjen e Subvencioneve, e publikuar ne gazetën zyrtare me datë 10.09.2025, dhe në Grup Punues caktohen:

1.1. Ilir Ferati, Kryetar i Komunës, Kryesues i Grupit Punues;
1.2. Genc Ademaj, Nënkryetar i Komunës, Koordinator i Grupit Punues;
1.3. Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit, anëtar;
1.4. Qendrim Ibrahimaj, ZKF, anëtar;
1.5. Abedin Kabashi, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, anëtar;
1.6. Kushtrim Buleshkaj, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, anëtar;
1.7. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit, anëtar;
1.8. Artan Gegaj, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, anëtar;
1.9. Agon Dreshaj, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar;
1.10. Fisnik Shoshaj, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi, anëtar;
1.11. Xhevat Demaj, Drejtor i Drejtorisë për Emergjenca, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar;
1.12. Dukagjin Hoxhaj, Drejtor i Drejtorisë për Inspekcion, anëtar;
1.13. Driton Alihajdaraj, Drejtor e Drejtorisë për Administratës Komunale, anëtar;
1.14.Merita Bytyçi, Drejtoreshë e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, anëtare;
1.15. Era Rexhaj, Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare;
1.16. Rasim Mahmutović, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
1.17. Brahim Hetemaj, Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi, anëtar;
1.18. Valentina Bytyçi, U.D Menaxhere e Burimeve Njerëzore, anëtare;
1.19. Afrim Metaj, U.D Udhëheqës i Sektorit Ligjor, anëtar;
1.20. Alketa Bujupaj-Bytyçi, Zyra e Kryetarit, anëtare;

2. Grupi punues i lartcekur, ka për obligim që të hartoj Plotësim –Ndryshimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025, dhe të njëjtin ta dërgoj në kuvend për miratim.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Grupi Punues.

4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Grupit Punues,
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

UD.Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim METAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI